

VENDIM
Nr.303, datë 25.3.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76 të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së përgjithshme të burgjeve, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi nr.96, datë 9.3.2000 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore së përgjithshme të burgjeve”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për ndjekjen dhe zbatimin e rregullore.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

PJESA E PARË
DISPOZITË E PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton mënyrën e realizimit të drejtave dhe detyrimeve të burgosurve, qofshin të dënuar me burgim apo të paraburgosur, organizimin e jetës së tyre, mënyrën dhe kushtet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, zhvillimin e aktivitetit të punës dhe shpërblimin për punën e kryer, si dhe mënyrën e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje me termat e mëposhtëm kuptohet:

1. “IEVP” nënkupton institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ku përfshihen paraburgimet dhe institucionet e vuajtjes së dënimit me burgim.
2. “I burgosur” nënkupton çdo të dënuar me burgim dhe çdo person ndaj të cilit është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.
3. “Personel” nënkupton çdo punonjës të administratës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në IEVP.

PJESA E DYTË
JETA E BRENDSHME E IEVP

KREU I DREJTIMI I SISTEMIT TË IEVP

Neni 3

Drejtimi i sistemit të IEVP

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është organ në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që organizon, drejton dhe kontrollon ekzekutimin e vendimeve penale me burgim dhe masave të sigurimit me “arrest në burg” në të gjithë sistemin e burgjeve. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve merr masat përkatëse për të siguruar zbatimin e ligjit të kësaj rregulloreje, të urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Drejtësisë.

2. Drejtori i IEVP është përgjegjës për organizimin dhe kontrollin e veprimtarisë në institucionin që drejton, në përputhje me aktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni si dhe me rregulloren e brendshme të IEVP.

3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtuesit e IEVP informojnë rregullisht Drejtorin e Përgjithshëm mbi aktivitetin e përditshëm të punës dhe aspekte të veçanta të saj.

4. Personeli i sistemit të IEVP është i detyruar të respektojë të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 4

Programi i veprimeve dhe i aktiviteteve në IEVP

1. Organizimi i veprimeve dhe realizimi i aktiviteteve në IEVP bëhet në përputhje me këtë rregullore, me rregulloren e brendshme të IEVP, strukturën, organikën, funksionet e përcaktuara dhe në bazë të programit të miratuar nga drejtori i IEVP.

2. Personeli, në përputhje me kompetencat e tij, vepron në bazë të këtij programi.

3. Drejtori i IEVP për zbatimin e programit ditor, ngarkon personelin me përgjegjësi të veçanta.

Neni 5

Njohja e të burgosurit me të drejtat dhe detyrimet

1. Çdo të burgosuri i bëhen të ditura të drejtat dhe detyrimet e tij që rrjedhin nga ligji, kjo rregullore dhe rregullorja e brendshme e IEVP. Për këtë qëlim nga administrata e IEVP, i vihen në dispozicion aktet e nevojshme ligjore e nënligjore.

2. Për të burgosurit që nuk dinë shkrim e lexim, komunikimi i akteve bëhet me gojë nga personeli përkatës.

3. Të burgosurit që nuk dinë gjuhën shqipe, i vihen në dispozicion këto akte në një gjuhë që ai e kupton.

KREU II

PRANIMI DHE REGJISTRIMI I TË PARABURGOSURVE DHE TË DËNUARVE ME BURGIM

Neni 6

Pranimi i të paraburgosurve

1. Pranimi i të paraburgosurve në IEVP, bëhet çdo ditë të javës, pasi të jetë vendosur nga gjykata masa e sigurimit “arrest në burg”.

2. Pranimi bëhet mbi bazën e dokumentacionit, i cili duhet të përmbajë detyrimisht këto dokumente:

- a) Vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”;
- b) Procesverbalin e ndalimit;
- c) Procesverbalin e kontrollit personal;
- ç) Formularin e identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve;
- d) Dokumentin e identifikimit;
- dh) Dokumentin e kontrollit mjekësor.

3. Kur mungojnë dokumentet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “dh” të këtij neni, IEVP nuk e pranon të paraburgosurin. Në rast se mungojnë dokumentet e kërkuara në shkronjën “d”, të këtij neni, i paraburgosuri mund të pranohet në IEVP. Institucioni duhet të marrë masat për plotësimin e dosjes personale të të paraburgosurit me dokumentet që mungojnë brenda një afati 15-ditor nga data e pranimi të tij.

Neni 7

Pranimi i të dënuarve

1. Pranimi i të dënuarve në IEVP bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, pasi të jetë lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin e gjykatës.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhrin e pranimi brenda një afati 3-ditor nga dita e ardhjes së urdhrin të ekzekutimit për vendimin e gjykatës.

3. I dënuari duhet të jetë i shoqëruar me dosjen e tij personale, e cila përmban:

- a) Vendimin e formës së prerë të gjykatës që cakton dënimin me burgim;
- b) Urdhrin e prokurorit për ekzekutimin e këtij vendimi;
- c) Vendimin e arrestit;
- ç) Procesverbalin e ndalimit;
- d) Procesverbalin e kontrollit personal;
- dh) Dëshminë e penalitetit;
- e) Formularin e identifikimit me dy foto dhe gjurmët e gishtërinjve;
- ë) Kartelën personale të të dënuarit;
- f) Kartelën e gjendjes shëndetësore.
- g) Dosjen psiko-sociale.

4. Kur mungojnë dokumentet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni, IEVP nuk e pranon të dënuarin. Në rast se mungojnë dokumentet e kërkuara në shkronjat e tjera të këtij neni, i dënuari mund të pranohet në IEVP. Institucioni duhet të marrë masat për plotësimin e dosjes personale të të dënuarit me dokumentet që mungojnë brenda një afati 15-ditor nga data e pranimi të tij.

Neni 8

Regjistrat dhe dosjet e IEVP

Në çdo IEVP hapen dhe mbahen këto regjistra dhe dosje:

- a) Regjistri themeltar i të dënuarve;
- b) Regjistri themeltar i të paraburgosurve;
- c) Dosja personale e të burgosurit;
- ç) Dosja psiko-sociale;
- d) Dosja shëndetësore;
- dh) Regjistri i kërkesë-ankesave;
- e) Regjistri i masave disiplinore;
- ë) Regjistri i lirimeve para kohe me kushte;
- f) Regjistri i lejeve të të burgosurve;
- g) Regjistri i ngjarjeve të rënda;
- gj) Regjistri i uljeve të dënimit;
- h) Regjistri i vizitave mjekësore;
- i) Regjistri i aktivitetit 24 orësh;
- j) Regjistri i punësimit.

Neni 9

Kontrolli dhe regjistrimi

1. Me paraqitjen e të burgosurit në IEVP, punonjësit përkatës verifikojnë identitetin dhe saktësinë e dokumentacionit të tij.

2. Kur identiteti dhe dokumentacioni është i rregullt, hartohet procesverbali i marrjes në

dorëzim të të burgosurit, dokumenteve shoqëruese dhe sendeve personale të tij. Në procesverbal shënohet data dhe ora e pranimit.

3. Në ato raste kur lindin dyshime për identitetin e të burgosurve ose rezultojnë mospërputhje në dokumentacion, njoftohet menjëherë prokurori.

4. Punonjësi i informacionit, organizon dhe mbikëqyr kontrollin e imët fizik të të burgosurit dhe në rast se konstaton sende që nuk lejohen të mbahen në regjim sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje, i regjistron në librin përkatës dhe harton një procesverbal, i cili nënshkruhet nga i burgosuri dhe kartelisti në dy kopje, ku njëra i jepet të burgosurit dhe tjetra ruhet në dosjen e tij.

5. Personeli i ngarkuar i institucionit bën regjistrimin e të burgosurve në regjistrin themeltar.

Neni 10

Dosja personale

1. Për çdo të burgosur hapet dosja personale, plotësimi i së cilës fillon që në momentin e pranimit në I EVP dhe vazhdon deri në lirimin e tij.

2. Dosja e shoqëron të burgosurin në rast transferimi në çdo I EVP tjetër.

3. Me përfundimin e vuajtjes së dënimit ose në rast lirimi, dosja arkivohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 11

Regjistrat themeltarë të të dënuarve dhe të paraburgosurve

Mbi bazën e procesverbaleve të pranimit, në çdo I EVP mbahet regjistri themeltar i të burgosurve, në të cilin pasqyrohen të dhënat e mëposhtme:

a) Informacion i plotë në lidhje me identitetin e të burgosurit (emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vëndbanimi, të afërmit me të cilët mund të komunikojë etj).

b) Informacion lidhur me veprën penale (vepra penale e kryer, masa e dënimit, gjykata që ka dhënë vendimin, numri dhe data e vendimit, data e arrestimit, vendi ku është arrestuar, data dhe urdhri i prokurorit për ekzekutimin e vendimit, çdo vendim i mëvonshëm gjykate që ndryshon vendimin e mëparshëm ose sjell pasoja në ekzekutimin e tij, çdo amnisti, falje etj).

c) Data, ora e pranimit dhe e lirimit. Në rast vdekjeje të burgosurit, pasqyrohen në regjistrin themeltar të të burgosurve, data, vendi dhe ora e vdekjes, shkaku i vdekjes, kopje e aktit të vdekjes dhe personi apo autoriteti të cilit i dorëzohet kufoma.

Neni 12

Numri identifikues i të burgosurit

Të burgosurit që në momentin e pranimit i caktohet një numër identifikues, i cili regjistrohet në regjistrin themeltar të I EVP.

Neni 13

Shfrytëzimi i të dhënave

1. Të dhënat lidhur me të burgosurit, duhet të mbahen në përputhje me karakterin konfidencial të tyre dhe mund të shihen vetëm nga Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Drejtori i I EVP, i burgosuri, nga çdo autoritet tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi ose nga personat e autorizuar prej tyre.

2. Të dhënat që ndodhen në regjister dhe në dosje regjistrohen në sistemin informatik sipas mënyrës së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

3. I burgosuri ose një person i autorizuar prej tij, mund t'i kërkojë drejtorit të I EVP të njihet me të dhënat personale të tij, pasi i deklaron drejtorit shkakun dhe llojin e informacionit që i duhet.

4. Drejtori i I EVP duhet të sigurohet që informacioni i dhënë nuk lidhet me një të burgosur tjetër.

5. Drejtori i I EVP nuk duhet të japë asnjë informacion që lidhet me sigurinë, pa lejen e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

6. Në rast se informacioni kërkohet nga një person i tretë, për dhënien e tij duhet marrë më

parë pëlqimi me shkrim i të burgosurit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 14

Veprimet paraprake gjatë pranimit

1. Menjëherë pas pranimit të të burgosurit, njoftohet personeli mjekësor, i cili është i detyruar të bëjë kontrollin mjekësor dhe për këtë harton një raport të përgjithshëm për drejtorin e IEVP, duke respektuar parimin e konfidencialitetit.

2. Pas kontrollit mjekësor, i burgosuri si rregull vendoset në seksionin e pranimit për një periudhë jo më të gjatë se 10 ditë nga pranimi i të burgosurit, ku nga Komisioni i Pritjes, kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) Kontrollon higjienën personale;
- b) Realizohet njohja me të dhënat personale, familjare, arsimin, profesionin, shkakun e kryerjes së veprës penale.

Për rezultatet e veprimeve të mësipërme, personeli përgjegjës përgatit raportin përmbledhës dhe bashkë me dokumentet e verifikimit, ia paraqet drejtorit të IEVP, së bashku me rekomandimet përkatëse.

3. Drejtori i IEVP ose një person i ngarkuar prej tij realizon një takim me të burgosurin, me qëllim që të njihen problemet personale dhe familjare, të cilat mund të influencojnë në përshtatjen me jetën e burgut dhe që mund të kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

4. Personeli i IEVP respekton të drejtën e të burgosurit për të mosinformuar familjarët apo persona të tjerë të afërm për qëndrimin e tij në IEVP, përveçse kur ekzistojnë arsye ligjore.

Neni 15

Komisioni i pritjes

1. Komisioni i Pritjes përbëhet nga personeli mjekësor, juridik, edukativ dhe ai i sigurisë.

2. Komisioni i Pritjes merr kontaktin e parë me të burgosurin dhe njihet me problemet, personalitetin e të burgosurit dhe nëse i burgosuri përbën rrezik për sigurinë e të burgosurve të tjerë ose të personelit, i bën të njohur atij rregullat e brendshme të institucionit, të drejtat dhe detyrat, duke i vënë në dispozicion materialet përkatëse, si dhe e informon për mënyrën e jetesës gjatë kohës së qëndrimit në institucion.

3. Në librin e Komisionit të Pritjes evidentohen të dhënat personale e familjare, arsimi, profesioni, vepra penale për të cilën akuzohet, konfliktet e mundshme dhe bën rekomandimet përkatëse, të cilat ia paraqet drejtorit të IEVP.

Neni 16

Kontrolli mjekësor

1. Çdo i burgosur ekzaminohet nga mjeku brenda 24 orëshve nga pranimi në IEVP.

2. Pas kontaktit me Komisionin e Pritjes i burgosuri i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimit mjekësor nga mjeku dhe stomatologu, të cilët hapin dhe kartelën mjekësore që e shoqëron të burgosurin gjatë gjithë periudhës së qëndrimit në IEVP dhe më tej.

3. Në përfundim të kontrollit dhe ekzaminimit mjekësor, mjeku informon drejtorin e IEVP rreth gjendjes së përgjithshme të të burgosurit.

4. Në raste konstatimi të shenjave të ushtrimit të dhunës ndaj të burgosurit, mbahet procesverbali përkatës dhe njoftohet menjëherë drejtuesi i IEVP dhe prokurori.

Neni 17

Sendet personale dhe ruajtja e tyre

1. Të burgosurit i lejohet të mbajë me shpenzimet e veta veshje dhe sende personale, sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të IEVP.

2. Në ambientet e brendshme të IEVP nuk lejohet mbajtja dhe qarkullimi nga të burgosurit i:
 - a) Sendeve që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e të burgosurve dhe të personelit, si dhe sigurinë në institucion;
 - b) Objekteve që përbejnë vepër penale;
 - c) Pajisje transmetimi dhe komunikimi, ku përfshihen aparatët celularë dhe fotografikë;
 - ç) Vlerave monetare të çdo lloji;
 - d) Aparateve dhe antenave dixhitale, pas vendosjes nga institucioni të antenave të përbashkëta;
 - dh) Pajisjeve të njëjta me ato që jepen nga institucioni, të cilat janë pjesë e dhomës apo të jetesës së përbashkët;
 - e) Pishtarë, qirinj, llampa vaji, pajisje filmi dhe video;
 - f) Sendeve me karakter diskriminues, provokues apo ushtarak;
 - g) Bizhuterive, përveç atyre të lejuara në rregulloren e brendshme.
3. Të gjitha sendet e ndaluara të të burgosurve, ruhen në zyrën e kartotekës sipas kushteve të përcaktuara me ligj, në këtë rregullore dhe në rregulloren e brendshme të institucionit, ndërsa vlerat monetare depozitohen në llogaritë personale të të burgosurit dhe mund të përdoren nga i burgosuri për nevoja të tij.
4. Sendet personale dhe vlerat monetare të të burgosurit i jepen atij në momentin e lirimit ose mund të tërhiqen në çdo kohë nga të afërmit e tij, sipas autorizimit të lëshuar nga i burgosuri kundrejt procesverbalit të firmosur nga marrësi dhe nëpunësi i IEVP.
Sendet që nuk mund të ruhen u dërgohen personave të autorizuar nga i burgosuri, me shpenzimet e veta.
5. Në rastet e transferimeve sendet i dorëzohen përgjegjësit të grupit të transferim- shoqërimit, së bashku me dokumentacionin e të burgosurit, kundrejt procesverbalit përkatës për t'u dorëzuar pranë institucionit ku transferohet.
6. Sendet e ndaluara, që ndodhen në regjimin e IEVP, inventarizohen në kartotekë dhe i kthehen të burgosurit me procesverbal në momentin e lirimit.
7. Për sendet që mund t'i shërbejnë hetimit mbahet një procesverbal, njoftohet prokurori dhe veprohet sipas udhëzimeve të tij.

Neni 18

Mjetet monetare

1. I burgosuri lejohet të depozitojë mjete monetare në llogari personale të hapura në IEVP apo në një institucion bankar. Në rastin e hapjes së llogarive në institucion bankar, marrëdhëniet midis institucionit bankar dhe IEVP rregullohen në marrëveshje të përbashkëta ku parashikohet mënyra e disponimit dhe përdorimit të mjeteve monetare nga të burgosurit.
2. IEVP vë në dispozicion të të burgosurit shumën e parave, e cila nuk mund të kalojë vlerën prej gjysmës së pagës minimale mujore në muaj, sipas kërkesës dhe nënshkrimit të të burgosurit. Mjetet monetare përdoren nga të burgosurit për blerje të sendeve, të cilat lejohen nga kjo rregullore ose rregullorja e brendshme e IEVP. Të burgosurit kanë të drejtë t'i dërgojnë mjete monetare familjes.

Neni 19

Kthimi i sendeve dhe mjeteve monetare të burgosurve

Pas lirimit i burgosuri merr me vete të gjitha sendet personale dhe të hollat e depozituara në llogarinë e tij, sipas procesverbalit të dorëzimit, të firmosur nga i burgosuri dhe punonjësi i autorizuar i IEVP.

KREU III

SHPËRNDARJA DHE AJRIMI I TË BURGOSURVE

Neni 20

Shpërndarja e të burgosurve

1. Në caktimin e IEVP ku do të vendoset i burgosuri, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

mban parasysh kriteret e vendosura në ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, dhe në ligjin "Për ekzekutimin e vendimeve penale", duke favorizuar kriterin e afërsisë së vendbanimit.

2. Në shpërndarjen e të burgosurve do të mbahen parasysh krijimi i lehtësirave për trajtimin dhe integrimin e tyre.

Neni 21

Vendosja nëpër dhoma

1. I burgosuri, qëndron në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 ditë dhe më pas vendoset në ambientin e banimit. Në vendosjen e të burgosurve nëpër dhoma mbahen parasysh kritere që lidhen me gjendjen e tyre gjyqësore, faktin nëse janë ose jo përsëritës, llojin e veprës penale, masën e dënimit, moshën, gjendjen shëndetësore dhe nevojat mjekësore, arsimin, veçoritë intelektuale dhe psikike, kërkesat e veçanta për trajtimin e tyre, problemet konfliktuale, fakti nëse janë nën hetim për të njëjtën çështje penale me persona të tjerë të ndaluar me urdhër të prokurorit apo të gjykatës.

2. Në çdo IEVP krijohen seksione sipas kategorizimit të përcaktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

3. Ndalohet mbajtja e të burgosurve të mitur në një dhome me të rriturit ose vendosja e të miturave vajza me të mitur djem në një dhomë. Të burgosurit e mitur vendosen në dhoma e seksione të veçuara, duke iu krijuar mundësi për një trajtim të veçantë.

4. Gratë e burgosura vendosen në dhoma dhe seksione të veçuara nga burrat dhe mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit femëror.

Neni 22

Dhomat dhe pajisjet e tyre

1. Në strehimin e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Drita artificiale duhet të plotësojë standardet e njohura teknike. Të burgosurve iu sigurohet energji elektrike e nevojshme për ndriçim dhe nevoja të higjienës personale.

2. Elementet e sigurisë që lidhen me parametrat e kërkuara për ndërtimin e burgjeve sipas shkallës së sigurisë, duhet të jenë në përputhje me normat europiane.

3. Drejtori i IEVP, në varësi të personalitetit të të burgosurit ose të të dhënave personale dhe penale të tij, mund të kufizojë mbajtjen e sendeve dhe objekteve të veçanta të dhomës ose ato personale, të cilat mund të favorizojnë dhunën kundër të tjerëve ose vetvetes në IEVP.

Neni 23

Veshjet dhe pajisjet e fjetjes

Çdo të burgosuri, i sigurohen shtresat, mbulesat për fjetje dhe veshje, në përputhje me kushtet klimaterike dhe nevojat shëndetësore të tij, sipas rregullores së brendshme.

Neni 24

Ajrimi

1. Të burgosurit dalin në ajrim në ambiente të hapura çdo ditë të javës përfshirë ditët e shtuna, të diela dhe të festave zyrtare dhe jo më pak se dy orë në vendin e caktuar sipas grafikut të miratuar.

2. Në raste të veçanta ose për të sëmurët, me rekomandim të mjekut të IEVP, lejohet dalja në ajrim shtesë, i cili duhet të shpjegojë me shkrim, arsyet e dhënies së kohës shtesë për ajrim dhe afatin e përcaktuar.

3. Dalja në ajrim bëhet me grupe ose individualisht. Të burgosurit e mitur dalin në ajrim të veçuar nga të burgosurit e tjerë. Në dalje dhe në hyrje bëhet kontrolli fizik i të burgosurve.

4. Gjatë kohës që kryhet ajrimi, veprimet e të burgosurve vëzhgohen.

5. Në rast se konstatohen shqetësime ndërpritet ajrimi dhe të burgosurit futen nëpër dhoma dhe raportohet te specialisti i informacionit, duke mbajtur një procesverbal.

Neni 25

Fjetja

Koha e pushimit (fjetjes) të të burgosurve bëhet duke respektuar orarin e veprimeve, të miratuar nga drejtori i IEVP.

KREU IV

USHQIMI I TË BURGOSURVE

Neni 26

Ushqimi

1. Të burgosurve iu sigurohet ushqim për tri vaktet, sipas normave dhe llojshmërisë së përcaktuar.

2. Të burgosurit i lejohet furnizimi nga familja dhe njësia e tregtimit në institucion 4 herë në muaj me produkte ushqimore, ku në çdo radhë mund të pranohen deri në 5 kg ushqime, 3 kg fruta, ndërsa lëngjet duhet të jenë me ambalazh të tejdukshëm dhe të hapura. Cigaret nuk llogariten në peshën e ushqimeve.

3. I burgosuri mund të blejë produkte ushqimore, cigare dhe sende të tjera në njësitë tregtare të IEVP, të përcaktuar në rregulloren e brendshme të IEVP, sipas sasisë së parashikuar në pikën 2, me të ardhurat që ka në llogarinë e tij.

4. Për të burgosurit që punojnë sigurohet dhe një ushqim suplementar pasdite, sipas rekomandimit të mjekut në përshtatje me punën e kryer.

5. Pas propozimit të mjekut të IEVP, institucioni i siguron të burgosurit të sëmurë dietë të veçantë.

6. Llojshmëria e ushqimit përcaktohet në tabela të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Norma e ushqimit është në përputhje me urdhrin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë. Respektimi i tyre verifikohet nga shërbimi shëndetësor i IEVP.

7. Në qoftë se i burgosuri, për shkak të ndërgjegjes ose besimit fetar, kërkon një ushqim të ndryshëm, kjo kërkesë respektohet nga personeli i IEVP, në përputhje me rregullat fetare dhe mundësitë praktike të IEVP.

8. Drejtori i IEVP merr masa për ngritjen e njësisë së tregtimit në IEVP, për plotësimin e nevojave të të burgosurve. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve miraton dhe kontrollon rregullisht veprimtarinë e lokaleve të tregtimit në IEVP.

Neni 27

Kontrolli i cilësisë së ushqimit

1. Personeli mjekësor dhe specialisti i informacionit, 30 minuta përpara ndarjes së ushqimit, kontrollojnë cilësinë dhe verifikojnë respektimin e normave të ushqimit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e “kontrollit të ushqimit”.

2. Për çdo vakt merren kampione nga ushqimi i gatuar, të cilët mbahen 24 orë, në kushte frigoriferike, të mbyllura dhe të vulosura nga specialisti i informacionit.

Neni 28

Shpërndarja e ushqimit

Ushqimi iu shërbehet të burgosurve në vendin dhe sipas grafikut të konfirmuar nga drejtori i IEVP, në përputhje me parashikimet e rregulloreve të brendshme të IEVP. Drejtori, merr parasysh

rekomandimet e doktorit rreth ushqimit për të burgosurit e sëmurë, si dhe shtesë në ushqim për të burgosurit që punojnë. Në raste të veçanta, siç janë festat zyrtare, ritet fetare, ngjarjet e jashtëzakonshme etj, me miratimin e drejtorit të IEVP-, ky orar mund të ndryshojë.

KREU V HIGJIENA VETJAKE DHE E MJEDISIT

Neni 29 **Shërbimet higjienike**

1. Shërbimet higjienike ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë kushtet normale për jetesë. Vendet ku kryhen këto shërbime pajisen me pajisjet hidrosanitare të nevojshme dhe kanë ujë të rrjedhshëm.

2. Shërbimet higjienike, vendosen në mjedise të veçanta, të ndara nga mjediset e tjera ku zhvillohen veprimtari të përbashkëta dhe në raporte të përshtatshme me numrin e të burgosurve.

Neni 30 **Higjiena personale dhe e mjediseve**

1. I burgosuri është i detyruar të kujdeset vazhdimisht për higjienën dhe pamjen e pastër e të rregullt të tij, si dhe të mbajë pastër e të rregullt dhomën dhe ambientet e përbashkëta.

2. Detergjentet pastruese e dezinfektuese dhe mjetet e tjera për pastrim, si rregull sigurohen nga IEVP, por lejohen që t'i sigurojnë dhe vetë të burgosurit me shpenzimet e tyre.

3. Kontrolli higjienosanitar i dhomave dhe i ambienteve të përbashkëta, bëhet çdo ditë nga personeli mjekësor dhe specialisti i regjimit të brendshëm, të cilët lënë detyrat përkatëse për të metat e konstatuara dhe informojnë drejtorin e IEVP për gjendjen.

Neni 31 **Pastrimi i dhomave**

1. Të burgosurit duhet të mbajnë pastër dhomat e tyre dhe ambientet e tjera të përbashkëta. Çdo IEVP parashikon në rregulloren e brendshme grafikun ditor të pastrimit të dhomave dhe ambienteve të përbashkëta, rregullat e pastrimit dhe kontrollin e tyre.

2. IEVP garanton ujin, detergjentet pastruese dhe dezinfektuese, si dhe mjetet e tjera të nevojshme për pastrim.

KREU VI SHËRBIMI SHËNDETËSOR

Neni 32 **Kontrolli mjekësor**

1. Drejtoria e IEVP siguron shërbimin mjekësor pa ndërprerje nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor. Brenda IEVP- krijohen seksione të specializuara kliniko-mjekësore dhe dentare.

2. Shërbimi shëndetësor i përgjigjet çdo kërkesë të të burgosurve, që lidhet me shëndetin e tyre dhe në mënyrë periodike ushtron kryesisht kontrolle mjekësore për të parë gjendjen e përgjithshme të të burgosurve dhe veçanërisht atë psikike. Çdo kontroll, duhet të dokumentohet në kartelën mjekësore të të burgosurit, e cila është pjesë e dosjes mjekësore të tij.

3. Mjeku i raporton drejtorit të IEVP kurdoherë që mendon se gjendja fizike e mendore e një të burgosurit është përkeqësuar ose do të keqësohet nga vazhdimi i qëndrimit në IEVP ose nga ndonjë kusht i saj.

Neni 33 **Kërkesa për vizitë mjekësore**

1. I burgosuri që ka nevojë të vizitohet, paraqet kërkesën për vizitë mjekësore te personeli

mjekësor i turnit, i cili harton listën përkatëse që i jepet mjekut të IEVP për të bërë vizita, me përjashtim të rasteve urgjente.

2. Lëvizja e të burgosurve për në infermieri dhe anasjelltas, me përjashtim të rasteve urgjente, bëhet një nga një, sipas kërkesës së mjekut, i shoqëruar. Gjatë vizitës mjekësore, punonjësi shoqëruar qëndron jashtë derës deri në mbarimin e vizitës.

3. I burgosuri është i detyruar të zbatojë udhëzimet e mjekut gjatë terapisë.

4. Pa dijeninë e mjekut, i burgosuri nuk mund të mbajë e të përdorë asnjë lloj medikamenti mjekësor.

Neni 34

Shërbimi stomatologjik

1. Në klinikën stomatologjike të institucionit, kryhet mjekimi i dhëmbëve për të burgosurit.

2. Personat e burgosur kanë të drejtë, që me mjetet e tyre financiare të mjekohen në klinika stomatologjike jashtë IEVP, kur ekzistojnë kushtet për një gjë të tillë.

Neni 35

Vizitat jashtë institucionit

1. Të burgosurit i lejohet që me shpenzimet e veta, të kryejë vizita dhe mjekime të specializuara në klinika të tjera jashtë institucionit, me miratimin e drejtorit të IEVP.

2. Transporti bëhet nga IEVP dhe shoqërohet nga mjeku ose ndihmësmjeku dhe punonjësit e policisë.

Neni 36

Barnat mjekësore, sigurimi dhe shpërndarja e tyre

1. Pas vizitës mjekësore, mjeku i IEVP ose mjeku specialist sipas llojit të sëmundjes, përcakton mjekimin e nevojshëm, i cili evidentohet në regjistrin e vizitave dhe kartelën mjekësore. Njëkohësisht u jepen rekomandimet e rastit personelit mjekësor dhe farmacistit për veprimet e mëtejshme.

2. Trajtimi me barnat mjekësore bëhet nga farmacia e IEVP, ndërsa shpërndarja bëhet nga personeli mjekësor.

3. Lejohet trajtimi me barna mjekësore të siguruara dhe nga vetë i burgosuri me shpenzimet e tij, por vetëm me lejen dhe sipas udhëzimeve të mjekut të IEVP.

Neni 37

Izolimi mjekësor

1. Në rastet e sëmundjeve ngjitëse mjeku vendos për izolimin e të burgosurit, duke e mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm dhe menjëherë njoftohet drejtori i IEVP për situatën.

2. Mjeku vendos pushimin e izolimit kur nuk ekzistojnë më shkaqet që çuan në vendosjen e tij.

3. Në rastet e konstatimit dhoma dezinfektohet, ndërsa i burgosuri izolohet në një ambient të veçantë ose dërgohet në Qendrën Spitalore të Burgjeve për mjekim të specializuar.

Neni 38

Lëvizja për në Qendrën Spitalore të Burgjeve

1. Për vizita dhe mjekime të specializuara si dhe në rastet e urgjencave apo të sëmundjeve ngjitëse, i burgosuri dërgohet në Qendrën Spitalore të Burgjeve ose institucione të tjera mjekësore.

2. Lëvizja e të burgosurit të sëmurë për në Qendrën Spitalore të Burgjeve ose në institucione të tjera mjekësore, kryhet me autombulancën e IEVP, i shoqëruar nga personeli shëndetësor dhe punonjësit e policisë së IEVP.

Neni 39

Të burgosurit me çrregullime mendore

1. Të burgosurit që konstatohen se vuajnë nga çrregullime të rënda mendore dërgohen në afatin më të shkurtër në institucione të përshtatshme psikiatrike për trajtimin e tyre me qëllim garantimin e trajtimit dhe të kujdesit mjekësor të specializuar.

2. Në varësi të kushteve materiale dhe të infrastrukturës që disponon, institucioni dhe sistemi i burgjeve në tërësi duhet të marrë të gjitha masat për trajtimin e të burgosurve, që konstatohet se vuajnë nga çrregullime mendore në reparte e njësi të specializuara pranë sistemit të burgjeve, ose për kurimin e tyre në institucione psikiatrike e mjekësore të specializuara për këtë qëllim.

Neni 40

Asistenca gjatë periudhës së shtatzënisë dhe menjëherë pas lindjes

1. Gratë e burgosura shtatzëna dhe ato lehona asistohen dhe trajtohen në qendra të specializuara të obstetrikës dhe gjinekologjisë jashtë burgut, duke përfshirë edhe procesin e lindjes.

2. Asistenca mjekësore për fëmijët e nënave të burgosura, jepet nga specialistë të pediatrikës.

3. Në qoftë se një fëmijë lind në IEVP, ky fakt nuk pasqyrohet në dokumentin e lindjes.

4. Për fëmijët nën 3 vjeç, duhet të sigurohet sistemimi në seksione të veçanta për nënat me fëmijë, me personel të kualifikuar brenda IEVP.

5. Kur fëmijët duhet të shkëputen nga nëna sepse kanë mbushur moshën 3 vjeç ose për arsye të tjera të ligjshme, sistemimi i tyre bëhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Familjes.

**PJESA E TRETË
REGJIMI NË IEVP**

**KREU I
SJELLJA NË INSTITUCION**

Neni 41

Të drejtat e të burgosurve

Gjatë qëndrimit në institucion të burgosurit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë këto të drejta:

a) Trajtim human, të barabartë dhe pa asnjë diskriminim të hapur ose të fshehtë mbi baza besimi, përkatësie fetare, etnike, politike, pozite sociale etj;

b) U sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët duke pasur kohë të mjaftueshme në kofidencë të plotë;

c) U sigurohet fjetje në krevat të veçantë me rroba fjetjeje sipas kushteve klimaterike;

ç) U sigurohet ushqim tre herë në ditë sipas normave të përcaktuara;

d) Të kenë llogarinë personale, të cilën mund ta përdorin për nevojat e tyre;

dh) Të takohen me familjarët e të afërmit e tyre dhe të marrin ushqim e rroba prej tyre, sipas rregullave 4 herë në muaj;

e) T'u sigurohet shërbimi mjekësor 24 orësh, nën kujdesin e personelit mjekësor në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë, si dhe të bëjnë vizita privatisht me shpenzimet e tyre;

ë) Të paraqesin kërkesa dhe ankesa te personeli i IEVP, si dhe çdo institucioni tjetër dhe të marrin përgjigje brenda afateve ligjore;

f) T'u sigurohet e drejta dhe fshehtësia e korrespondencës;

g) Kanë të drejtën e bisedave, telefonatave;

gj) Kanë të drejtën e ajrimit;

h) Të marrin pjesë në aktivitete argëtuese, edukative dhe pune, që organizohen nga IEVP.

i) Të ushtrojnë besimin dhe ritet fetare;

j) T'u sigurohet asistencë social psikologjike dhe konsulencë juridike;

k) Shtetasit e huaj kanë të drejtë të marrin kontakte me përfaqësitë diplomatike të vendit të

tyre, si dhe të njihen me të drejtat dhe detyrat e tyre;

l) Të përdorin sendet personale të lejuara në këtë rregullore dhe në rregulloret e brendshme të IEVP.

Neni 42

Detyrat e të burgosurve

Të burgosurit kanë për detyrë:

- a) Të mbajnë të pastër e të rregullt dhomën e tyre dhe ambientet e përbashkëta;
- b) Të kujdesen për higjienën personale;
- c) Të mos mbajnë dhe qarkullojnë sende të ndaluara, të cilat rrezikojnë rendin, jetën dhe shëndetin e të burgosurve dhe personelit, objekte që përbëjnë vepër penale, mjete që ndikojnë negativisht në hetim, si dhe vlera monetare të çdo lloji;
- ç) Të krijojnë marrëdhënie korrekte me të burgosurit e tjerë, si dhe me personelin e institucionit;
- d) Të zbatojnë urdhrat e personelit të institucionit;
- dh) Të dëmshpërblejnë vlerën përkatëse në rastet e dëmtimit të materialeve që janë pronë e institucionit ose e të burgosurve të tjerë;
- e) Të zbatojnë programin ditor të institucionit;
- ë) Të respektojnë dinjitetin e pjesëtarëve të komunitetit dhe të personelit;
- f) Të informojnë menjëherë drejtorin e IEVP, për rrethanat që mund të rrezikojnë sigurinë, jetën e të burgosurve ose shkeljen e rregullave të brendshme në IEVP.

Neni 43

Vlerësimi i sjelljes së të burgosurve

1. Personeli i IEVP çdo 6 muaj duhet të plotësojnë vlerësimin e sjelljes për çdo të burgosur që administrohet në dosjen psiko-sociale të tij.

2. Për seancat gjyqësore me objekt ulje dënimi, pasqyrohen në vlerësimin e sjelljes së të burgosurit, të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj të burgosurit për vitin e fundit të vuajtjes së dënimit.

3. Për seancat gjyqësore me objekt lirim me kusht, pasqyrohen në vlerësimin e sjelljes të gjitha masat disiplinore të dhëna ndaj të burgosurit gjatë 3 vjetëve të fundit të vuajtjes së dënimit.

Neni 44

Komisioni i vlerësimit të sjelljes

Komisioni i vlerësimit të sjelljes së të burgosurve ngrihet në IEVP, dhe ka në përbërje të tij Drejtorin ose Zv/drejtorin e IEVP.-së, përgjegjësin e sektorit të kujdesit social, edukatorin e grupit, specialistin e regjimit të brendshëm dhe juristin.

Neni 45

Detyrat për punën në grup

1. Të burgosurve që tregojnë aftësi të veçanta për bashkëpunim në realizimin e programeve të IEVP, drejtoria mund t'u besojë detyra me karakter kulturor, krijues dhe sportiv, që përbëjnë aktivitete në grup.

2. Detyrat e mësipërme zhvillohen nën drejtimin e personelit të IEVP, i cili duhet të garantojë mosushtrimin e tyre si fuqi komanduese ose pozicion superior mbi të burgosurit.

Neni 46

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

1. Në rast të dëmtimit të një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, pronë e IEVP, drejtoria e institucionit duhet të përcaktojë dëmtuesin dhe masën e dëmit dhe pasi dëgjon të burgosurin përgjegjës, e njofton atë për vlerën e dëmit, duke e ftuar për ta shlyer atë vullnetarisht, në rast të

kundërt drejtori i institucionit ndjek rrugë të tjera ligjore. Mënyra e pagimit të dëmit caktohet nga drejtori i I EVP.

2. Në rast të dëmtimit të pasurisë së të burgosurve të tjerë, drejtorja e I EVP, ndërmjetëson për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjes. Dëshmëpërblimi vullnetar përbën rrethanë lehtësuese në marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Neni 47

Kontrollet

1. Të gjithë të burgosurit dhe personat që kanë të drejtë të marrin takim me ta, i nënshtrohen kontrollit nga ana e Policisë së Burgjeve. Personeli që bën kontrollin duhet të jetë i të njëjtit seks me atë të personit që kontrollohet.

2. Në rast urgjence, personeli i autorizuar mund të ushtrojë kontroll me iniciativën e tij, duke njoftuar menjëherë drejtorin e I EVP.

3. Për kryerjen e kontrollit të përgjithshëm, drejtori i I EVP mund të kërkojë bashkëpunimin e strukturave të Policisë së Shtetit, të cilat detyrohen t'i përgjigjen kësaj kërkesë.

4. Kontrollet e vizitorëve, të burgosurve dhe të dhomave të tyre, duhet të bëhen duke respektuar personalitetin e të kontrolluarit dhe pa dëmtuar sendet që posedojnë ata.

5. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ushtron kontrolle për sende të ndaluara dhe elementet e sigurisë në I EVP.

6. Ushtrimi i kontrollit personal të anësive kryhet nga personeli mjekësor dhe lejohet të bëhet vetëm kur ekziston një dyshim i arsyeshëm se i burgosuri mban sende të ndaluara, sipas rregullave në fuqi.

Neni 48

Lëvizja dhe shoqërimi i të burgosurve jashtë I EVP

1. Lëvizja dhe shoqërimi i të burgosurve jashtë I EVP, si për në gjykatë, prokurori, polici gjyqësor, spitale, institucione të tjera mjekësore private, burgje apo për të kryer veprime procedurale që ligji procedural parashikon se i burgosuri merr pjesë, kryhet nga shërbimi i transferim shoqërimeve ose personeli i autorizuar.

2. Në të gjitha rastet lëvizja dhe shoqërimi i të burgosurit shoqërohet me dokumentacionin përkatës.

KREU II

DISIPLINA DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 49

Shkeljet disiplinore

1. Disiplina dhe rregulli organizohen në interes të normalitetit dhe sigurisë së I EVP.

2. Regjimi disiplinor organizohet në mënyrë që t'i përshtatet seksit, moshës, të dhënave fizike dhe psikike të të burgosurit.

3. Ndaj të burgosurve nuk mund të jepen masa disiplinore, për një fakt që nuk është parashikuar shprehimisht si shkelje.

4. Masa disiplinore caktohet në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të burgosurit ndaj saj, si dhe të dhënat individuale të tij.

5. Masat disiplinore zbatohen duke respektuar personalitetin e të burgosurit.

6. Shkeljet disiplinore klasifikohen në shkelje shumë të rënda, shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.

7. Konsiderohen shkelje shumë të rënda disiplinore:

a) Organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e çrregullimeve në funksionimin e I EVP;

b) Përvetësimi ose dëmtimi me dashje i pasurisë së I EVP ose të burgosurve të tjerë;

- c) Ushtrimi i dhunës fizike ose psikike ndaj të burgosurve të tjerë;
 - ç) Përdorimi i fjalëve të pahijshme e fyese ndaj personave të tjerë;
 - d) Dhuna verbale ndaj të burgosurve të tjerë;
 - dh) Përdorimi i lëndëve narkotike dhe alkoolit;
 - e) Përgatitja dhe përpjekja për t'u larguar nga IEVP ose gjatë shoqërimit të tij;
 - ë) Kundërshtimi me dhunë ndaj punonjësve të IEVP;
 - f) Shkelja e afatit të kthimit në IEVP pas lejes, pa arsye objektive të vërtetuara.
8. Konsiderohen shkelje të rënda disiplinore:
- a) Prishja e qetësisë dhe rendit;
 - b) Kryerja e veprimeve ose akteve me qëllime përfitimi;
 - c) Dhënia e alkoolit të tretëve;
 - ç) Moszbatimi i detyrimeve dhe urdhrave ose vonimi i pajustificuar i zbatimit të tyre.
9. Konsiderohen shkelje të lehta disiplinore:
- a) Neglizhenca në kryerjen e pastrimit personal, të dhomës apo të ambienteve të përbashkëta;
 - b) Simulimi i sëmundjes;
 - c) Mbajtja, përdorimi, shpërndarja dhe qarkullimi i sendeve të ndaluara;
 - ç) Shkruajtja apo gërvishtja e mureve, dëmtimi i llampës së ndriçimit, lëvizja e krevatit.

Neni 50

Masat parandaluese

Në raste urgjente, në mënyrë që të parandalohet dëmi ndaj njerëzve, prishja e rregullit, përhapja e trazirave, si dhe në rrethana të jashtëzakonshme, drejtori i IEVP mund të marrë masa, duke përjashtuar një të burgosur nga aktivitetet në grup dhe duke e vendosur në një dhomë të veçantë në pritje të mbledhjes së komisionit disiplinor të IEVP, i cili vendos për masën disiplinore.

Neni 51

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore jepen nga e lehta deri te më e rënda, sipas klasifikimit të shkeljeve.
2. Për shkeljet disiplinore shumë të rënda zbatohen këto masa:
 - a) Përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë, në ambiente të veçanta;
 - b) Ndërprerja e lejeve për një periudhë gjashtëmujore.
3. Për shkeljet disiplinore të rënda zbatohen këto masa:
 - a) Përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë, në ambiente të veçanta;
 - b) Përjashtim nga ajrosja në grup, por jo më shumë se 20 ditë.
4. Për shkeljet disiplinore të lehta zbatohen këto masa:
 - a) Vërejtje;
 - b) Vërejtje në prani të të burgosurve.
5. Ndaj të burgosurve merren masa disiplinore, në përputhje me rregullat në fuqi dhe asnjëherë dy herë për të njëjtën shkelje.
6. Për shkelje të përsëritura brenda të njëjtit klasifikim jepet një masë më e rëndë, për shkelje të klasifikimeve të ndryshme, jepet masa e klasifikimit më të rëndë. Për disa shkelje brenda të njëjtit klasifikim, jepet masa disiplinore më e rëndë.

Neni 52

Komisioni disiplinor dhe procedimi disiplinor

1. Kur nga personeli i IEVP konstatohen shkelje disiplinore, mbahet një procesverbal, i cili i dorëzohet menjëherë drejtorit të IEVP.
2. Në rastet e shkeljeve të lehta të parashikuara në nenit 51 të kësaj rregulloreje, masa vendoset nga drejtori i institucionit, pas sqarimit të rrethanave dhe komunikimit me të burgosurin, pasi i garantohet e drejta e mbrojtjes.

3. Në rastet e shkeljeve shumë të rënda dhe të rënda të parashikuara në neni 51 të kësaj rregulloreje, masa vendoset nga komisioni disiplinor i I EVP.

4. Komisioni disiplinor përbëhet nga drejtori i I EVP me cilësinë e kryetarit, dhe me cilësinë e anëtarit, personeli i kujdesit social, personeli shëndetësor dhe personeli i sigurisë.

5. Komisioni ngrihet dhe funksionon me urdhër të drejtorit të I EVP. Drejtori i I EVP, mbledh komisionin disiplinor jo më vonë se 48 orë nga momenti i kryerjes së shkeljes. Mbledhjet e Komisionit asistohen nga juristi i I EVP.

6. Gjatë mbledhjes së komisionit disiplinor, i burgosuri dëgjohet për pretendimet e tij. Të burgosurit i lejohet mbrojtja me avokat. Për të burgosurit e huaj duhet të sigurohet ndihma e një përkthyesi.

7. Nëse shkelja vërtetohet, komisioni disiplinor merr vendimin përkatës me shumicë votash. Vendimi i komunikohet të burgosurit, të cilit i jepet një kopje e tij. Vendimi mund të ankimohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Ndaj të burgosurve të mitur dhe grave, masat e rënda dhe shumë të rënda të parashikuara në nenin 51 të kësaj rregulloreje, mund të jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar.

9. Përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta të parashikuara në nenin 51 të kësaj rregulloreje, nuk mund të ekzekutohet pa pëlqimin me shkrim të lëshuar nga mjeku, ku dëshmohet se i burgosuri mund ta përballojë atë.

10. Masat disiplinore evidentohen në regjistër dhe në dosjen e të burgosurit.

Neni 53

Pezullimi i masave disiplinore

1. Me kërkesën e të burgosurit, drejtori i I EVP mbledh komisionin disiplinor, i cili mund ta pezullojë ekzekutimin e masave disiplinore, duke urdhëruar vënien në provë të të burgosurit për një periudhë nga një deri në tre muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe ai të mos kryejë shkelje disiplinore.

2. Drejtori i I EVP, pezullon ekzekutimin e masave disiplinore, në rastet kur mjeku deklaron me shkrim se kushtet shëndetësore të të burgosurit nuk lejojnë ekzekutimin e masave disiplinore.

KREU III

MJETET E FORCËS DHE TE SHTRËNGIMIT FIZIK

Neni 54

Përdorimi i forcës

1. Personeli i I EVP ndalohet të kryejë ndaj të burgosurit veprime të kundërligjshme, ndëshkime, tortura, trajtime ç'njerëzore, poshtëruese, diskriminuese, si dhe çdo lloj tjetër dhune.

2. Përdorimi i forcës dhe i shtrëngimit, nuk duhet të përdoret si dënim, por bëhet vetëm për të shmangur:

a) Prishjen e rregullit dhe sigurisë në institucion;

b) Përpjekjet për t'u larguar nga burgu apo gjatë transferimit dhe shoqërimit;

c) Dhunën dhe kërcënimin ndaj personave të tjerë;

ç) Dëmtimin e shëndetit të vet ose të personave të tjerë;

d) Dëmtimin e rëndë të sendeve;

dh) Kundërshtimin aktiv në zbatimin e rregullave dhe urdhrave ose në ekzekutimin e një dënimi disiplinor.

3. Përdorimi i forcës ndalon menjëherë, me ndërprerjen e kundërshtimeve nga i burgosuri.

4. Në rast lëndimi të të burgosurit, atij i jepet menjëherë ndihma mjekësore, e cila pasqyrohet në kartelën mjekësore.

5. Në raste të tejkalimit të masës së përdorimit të forcës nga ana e punonjësve të I EVP, ndaj tyre veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 55
Mjetet e forcës dhe të shtrëngimit fizik

1. Personeli i IEVP, përveç rasteve të operacioneve emergjente, nuk mban brenda regjimit të brendshëm të institucionit armë vdekjeprurëse.
2. Mbajtja e armëve të tjera duke përfshirë shkopinjtë e gomës nga personat në kontakt me të burgosurit ndalohet brenda perimetrit të IEVP, me përjashtim të rasteve kur ato nevojiten për sigurinë në IEVP.
3. Personeli nuk pajiset me armë nëse ai nuk është trajnuar për përdorimin e tyre.
4. Llojet e armëve dhe mënyra e përdorimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV
KËRKESAT, ANKESAT DHE AFATI I SHQYRTIMIT

Neni 56
Kërkesat dhe ankesat

1. Gjatë pranimit në institucion, i burgosuri njihet me të drejtat dhe detyrat, si dhe me mënyrën e paraqitjes së kërkesave dhe ankesave.
2. Të burgosurit duhet t'i krijohet mundësia që çdo ditë, me anë të formularëve ose përjashtimisht në mënyrë verbale nëpërmjet personelit të IEVP, të paraqesë kërkesë, ankesë, ose të kërkojë takim me drejtorin e IEVP apo personelin përgjegjës.
3. Personat e autorizuar duhet të organizojnë takime me të burgosurit për t'u krijuar mundësinë e paraqitjes së kërkesëankesave të tyre. IEVP mundëson takime konfidenciale të të burgosurve me anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës, Avokatin e Popullit dhe punonjësit e zyrës së tij, mbrojtësin e kërkuar nga i burgosuri ose të caktuar kryesisht, përfaqësues të OJF-ve, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut ose të organizmave ndërkombëtare.
4. Kërkesat ose ankesat, pasi regjistrohen në një libër të veçantë, i dorëzohen drejtorit të IEVP, i cili ka detyrimin të caktojë punonjësin përkatës për zgjidhjen dhe kthimin e përgjigjes të burgosurit. Për kërkesat dhe ankesat që i drejtohen IEVP, përgjigja duhet të jepet brenda 15 ditëve.
5. I burgosuri mund të paraqesë kërkesë apo ankesë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Avokatit të Popullit, Prokurorit, Gjykatës, Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, apo institucioneve të tjera shtetërore, si dhe të marrë përgjigje brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

KREU V
KONTAKTET ME BOTËN E JASHTME

Neni 57
Takimi me familjen, të afërmit dhe miqtë

1. Të burgosurit kanë të drejtë të marrin ushqim dhe të takohen 4 herë në muaj me familjarët, të afërmit dhe miqtë e tyre. Drejtori i IEVP, mund të japë takim dhe ushqime shtesë të arsyetuar, për të burgosurit.
2. Një nga takimet është i zgjatur deri në 5 orë, për të burgosurit e martuar dhe me fëmijë.
3. Takimet bëhen çdo ditë sipas orarit të veprimeve të IEVP, në vendet e përcaktuara në rregulloret e IEVP.
4. Në çdo takim, lejohen fëmijët e mitur dhe tre persona madhorë.
5. Drejtori i IEVP, me kërkesë të prokurorit apo të gjykatës, mund ta kufizojë të drejtën e të burgosurit të presë vizita, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

Neni 58

Procedurat për takimet me familjarët të afërmit dhe miqtë

1. Me paraqitjen e kërkesës të të interesuarit për takim me të burgosurin, verifikohet rregullsia e dokumentit të identifikimit dhe përputhja me personin, bëhet verifikimi i numrit të takimeve dhe sasisë së ushqimeve në “Librin e indeksit alfabetik”, dhe më pas bëhet regjistrimi në “Librin e takimeve të të burgosurve me familjarët”, duke i dhënë numrin e radhës së takimit të interesuarit për takim.

2. Më pas njoftohet përgjegjësi i regjimit të brendshëm, i cili lajmëron të burgosurin mbi ardhjen e familjarëve dhe merr masa për shoqërimin e të burgosurit për takim. I burgosuri kur shkon për takim duhet të jetë i shoqëruar. Para futjes në vendet e takimit, të burgosurit i bëhet kontrolli fizik nga nëpunësi i IEVP, që ka të njëjtën gjini dhe pastaj lejohet kalimi i tij për në vendin e takimit. Në rast konstatimi të posedimit të sendeve të ndaluara nga ana e të burgosurit, njoftohet punonjësi i informacionit dhe mbahet një procesverbal. E njëjta procedure ndiqet dhe në kthim.

3. Personat vizitorë i nënshtrohen kontrollit fizik nga nëpunësi i IEVP, që ka të njëjtën gjini përpara futjes në takim. Sendet që ka me vete personi vizitor vendosen në kaseta të veçanta, të cilat ju jepen pas përfundimit të takimit.

4. Në rastet kur konstatohet se nga vizitorët tentohet të futen sende të ndaluara, që i posedojnë vetë ose janë futur në ushqime dhe veshmbathje, pezullohet takimi dhe informohet menjëherë specialisti i informacionit dhe prokurori. Për rastet e sendeve të ndaluara që përbejnë vepër penale, me ndalimin e personit bëhet kallëzimi për ndjekje penale.

Neni 59

Vëzhgimi i takimeve

1. Punonjësi shoqërues i takimeve, pas futjes së familjarëve dhe të burgosurve në dhomën e takimit vëzhgon takimin. Takimet zhvillohen në vendet e caktuara nën kontroll shikimi e jo dëgjimi nga personeli mbikëqyrës.

2. Në rast se punonjësi shoqërues i takimit, konstaton se palët kërkojnë të shkëmbejnë sende të ndaluara, ndërpret menjëherë takimin dhe njofton specialistin e informacionit dhe inspektorin e regjimit të brendshëm.

3. Në përfundim të kohës së takimit, punonjësi vëzhgues i takimeve lajmëron punonjësin përgjegjës, i cili merr të burgosurin për ta shoqëruar për në dhomat e burgimit dhe njofton specialistin e informacionit për shoqërimin dhe daljen e vizitorëve nga institucioni.

Neni 60

Korrespondenca

1. Çdo i burgosur ka të drejtë të mbajë korrespondencë.

2. Për të burgosurit që nuk i kanë mundësitë, personeli i IEVP, vë në dispozicion mjetet e nevojshme për korrespondencë.

3. Korrespondenca duhet të hidhet në kutinë postare të IEVP. Letrat merren nga një punonjës i postës, dy herë në javë dhe postohen sipas destinacionit. Shpërndarja e korrespondencës së ardhur, bëhet nga personeli i IEVP duke ruajtur fshehtësinë e saj.

4. Në rastet kur ka dyshime të bazuara se në korrespondencë ka sende të ndaluara, ajo hapet në prezencë të të burgosurit dhe të drejtuesve të IEVP.

5. Drejtori i IEVP, me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, mund të kufizojë të drejtën e të burgosurit për korrespondencë, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

Neni 61

Bisedat telefonike

1. Të burgosurit i lejohet korrespondenca telefonike 8 (tetë) herë në muaj me familjarët, të

afërmit dhe miqtë e tij. Drejtori i IEVP mund të autorizojë thirrje të tjera telefonike më situata të jashtëzakonshme. Për çdo bisedë telefonike, i burgosuri deklaron numrin e telefonit drejt të cilit do të kryhet thirrja dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 10 minuta. Shërbimi telefonik ofrohet nëpërmjet aparatit kartofonik të IEVP, sipas grafikut të telefonatave të miratuara nga drejtori i IEVP dhe kostoja e këtyre telefonatave përballohet nga vetë i burgosuri. Bisedat telefonike zhvillohen nën kontroll shikimi e jo dëgjimi nga personeli mbikëqyrës.

2. Në rastet kur të burgosurit nuk kanë mjete financiare për të kryer biseda telefonike me familjarët, iu sigurohet korrespondenca telefonike 1 (një) herë në muaj deri në 5 minuta me shpenzimet e IEVP.

3. Drejtori i IEVP me kërkesë të prokurorit ose gjykatës, mund ta kufizojë të drejtën e të burgosurit për korrespondencë telefonike nëse është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale.

Neni 62

Takimet e të burgosurve të huaj me përfaqësitë diplomatike

1. Të burgosurit me shtetësi të huaj i krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme për komunikimin me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit përkatës.

2. Të burgosurit, shteti i të cilit nuk ka përfaqësi në Republikën e Shqipërisë, refugjatëve, si dhe personave pa shtetësi, u krijohen të njëjtat lehtësira për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatike të shtetit që merr përsipër mbrojtjen e interesave të tyre ose me autoritetet kombëtare apo ndërkombëtare që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.

3. Drejtorja e IEVP bashkëpunon me përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë.

KREU VI

TAKIMET ME PROKURORË, AVOKATË DHE INSTITUCIONE TË TJERA

Neni 63

Takimet me prokurorë, avokatë ose oficerë të policisë gjyqësore

1. Të burgosurit marrin takim me prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore ose avokatët, sa herë që këta të fundit e shikojnë të arsyeshme gjatë procesit të hetimit.

2. Për të burgosurit e mitur prania e avokatit dhe e psikologut, është e domosdoshme.

3. Takimi i prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore dhe avokatit, lejohet çdo ditë si rregull nga ora 08:00 deri në orën 19:00. Takimet nuk vëzhgohen.

Neni 64

Takimet me Avokatin e Popullit

1. Të burgosurit kanë të drejtë të paraqesin ankesa, si dhe të takohen me Avokatin e Popullit.

2. Takimi i të burgosurve me Avokatin e Popullit nuk vëzhgohet.

Neni 65

Takimet me noterët dhe punonjësit e gjendjes civile

1. Për efekt të kryerjes së veprimeve ligjore, si lidhje dhe zgjidhje kontrate, hartimin e akteve të shitblerjes apo huasë, kalim trashëgimie etj, i burgosuri lejohet të kontaktojë me noterin e zgjedhur prej tij ose nga të afërmit e tij apo pala tjetër, me pëlqimin paraprak të të burgosurit.

2. Për efekt të kryerjes së procedurave dhe evidentimit në dokumentet përkatëse të fakteve të tilla si, celebrim martesor, lindje etj, i burgosuri lejohet të takohet me punonjësin e zyrës së gjendjes civile.

3. Faktet e martesave, lindjeve, si dhe fakte të tjera të kësaj natyre, të ndodhura gjatë periudhës së qëndrimit në institucion, evidentohen në regjistrin themeltar.

Neni 66
Hyrja në institucion

1. Subjektet e përmendura në nenin 43 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të cilët kanë të drejtë të hyjnë në IEVP me autorizim, paraqesin kërkesë drejtorit të IEVP.

Kërkesa, duhet të shpjegojë hollësisht arsyet për të cilat kërkohet hyrja në institucion dhe duhet të shoqërohet me dokumentin e identifikimit të kërkuarit, CV e tij, dokumentet që vërtetojnë arsyen e kërkesës, në rast se ka. Kur kërkuari është një person juridik, kërkesa duhet të shoqërohet me autorizimin për t’u përfaqësuar nga personi/at fizik të caktuar në kërkesë.

2. Drejtori i IEVP, pasi regjistron menjëherë kërkesën, e shqyrton atë dhe njofton kërkuarin për autorizimin apo refuzimin e autorizimit për të hyrë në IEVP, brenda një afati 5-ditor nga dita e marrjes së kërkesës. Refuzimi i autorizimit për të hyrë në IEVP duhet të jetë i motivuar.

3. Subjektet kanë të drejtë të ankohen te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, lidhur me refuzimin për hyrjen në IEVP. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve shqyrton ankesën brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj dhe kthen përgjigje të arsyetuar lidhur me pranimin ose refuzimin e ankesës.

KREU VII
LEJET

Neni 67
Shqyrtimi i kërkesave për leje shpërblyese apo të veçanta

1. Kërkesa e të dënuarit për leje shpërblyese apo e të burgosurve për leje të veçantë, i drejtohet drejtorit të IEVP, i cili e regjistron atë në një regjistër të veçantë të krijuar për këtë qëllim.

2. Miratimi apo refuzimi i kërkesave për leje shpërblyese apo të veçanta nga drejtori i IEVP, duhet të jepet në respekt të të drejtave ligjore të të burgosurve, të parimit të barazisë midis të burgosurve që plotësojnë kushtet dhe detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe të parimit të proporcionalitetit midis vendimit të refuzimit të lejes shpërblyese apo të veçantë dhe arsyes në të cilën është mbështetur vendimi i refuzimit.

Neni 68
Lejet shpërblyese në burgjet dhe seksionet e sigurisë së ulët dhe të zakonshme

1. Për seksionin e sigurisë së zakonshme dhe të ulët, drejtori i IEVP është personi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së të dënuarit për leje shpërblyese sipas procedurës së mëposhtme:

a) Pas marrjes së kërkesës nga i dënuari drejtori IEVP, urdhëron brenda ditës së paraqitjes së kërkesës, përgjegjësin e sektorit ligjor, përgjegjësin e sektorit të sigurisë dhe përgjegjësin e kujdesit social, mbi verifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për miratimin e lejeve shpërblyese.

b) Përgjegjësi i sektorit ligjor, përgatit brenda një afati 1-ditor nga dita e marrjes së urdhrin, raportin i cili shpjegon dhe dokumenton se kushti lidhur me kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit është plotësuar ose jo, ditët e lejeve shpërblyese që i dënuari ka përfituar që nga fillimi i vitit, si dhe propozimin e argumentuar të dhënies ose jo të lejes shpërblyese dhe të ditëve që i dënuari duhet të marrë si leje shpërblyese.

c) Përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i kujdesit social, përgatisin brenda një afati 1-ditor nga dita e marrjes së urdhrin, raportin e përbashkët, i cili shpjegon dhe dokumenton se kushti lidhur me respektimin e kësaj rregulloreje dhe rregullores së brendshme të IEVP nga i dënuari, sjelljen e të dënuarit, rrezikshmërinë e tij, interesin që paraqet për rehabilitimin e të dënuarit, sjelljen e të dënuarve lidhur me punonjësit e IEVP dhe të dënuarit e tjerë, ndjenjën e përgjegjësisë, pjesëmarrjen e tij në aktivitete arsimore, kulturore, të punës e sportive të organizuara nga IEVP, besueshmërinë që paraqet i dënuari lidhur me qëndrimin e tij jashtë IEVP, si dhe propozimin e miratimit apo refuzimit të lejes shpërblyese dhe të ditëve që i dënuari duhet të marrë si leje shpërblyese.

ç) Raportet, propozimet dhe dokumentacioni i paraqiten, brenda një afati 1-ditor, drejtorit të IEVP, i cili e shqyrton dhe jep miratimin apo refuzimin e motivuar.

d) Leja shpërblyese mund të miratohet nga drejtori i IEVP, vetëm pasi të ketë marrë të paktën dy mendime në favor të miratimit të saj nga përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i kujdesit social.

2. Leja shpërblyese nuk mund të jepet më shumë se 10 ditë dhe në total nuk mund të jetë për më shumë se 20 ditë në vit. Për të dënuarit e mitur kohëzgjatja e lejeve shpërblyese nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë për çdo rast dhe në total nuk mund të jetë më shumë se 45 ditë në vit. Në çdo rast, nga miratimi i lejes shpërblyese të fundit duhet të kenë kaluar të paktën 3 muaj.

3. Drejtori IEVP i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Ministrit të Drejtësisë, brenda 24 orëve nga miratimi i lejes shpërblyese njoftimin për dhënien e lejes shpërblyese dhe brenda 5 ditëve, të gjithë dokumentacionin që ka shërbyer për të miratuar lejen shpërblyese.

Neni 69

Lejet shpërblyese në burgjet dhe seksionet e sigurisë së lartë

1. Lejet shpërblyese në burgjet apo seksionet e sigurisë së lartë, jepen vetëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, apo me autorizimin e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

2. Ministri i drejtësisë me marrjen e kërkesës nga i dënuari i kërkon drejtorit të IEVP përkatës, të përgatisë brenda një afati 7-ditor të gjithë dokumentacionin e parashikuar në nenin 68 të kësaj rregulloreje, si dhe mendimin e tij lidhur me miratimin apo refuzimin e lejes shpërblyese.

3. Në rast refuzimi, i dënuari mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes shpërblyese.

Neni 70

Lejet e veçanta

1. Drejtori i IEVP është personi përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së të burgosurit për leje të veçanta sipas procedurës së mëposhtme:

a) Kërkesa e të burgosurit duhet të jetë e argumentuar dhe e shoqëruar nga dokumentacioni përkatës. Në raste të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes së të burgosurit kërkesa duhet të shoqërohet me raportin mjekësor të familjarit të sëmurë ku vërtetohet gjendja e rëndë shëndetësore e tij. Në rastet e ngjarjeve të rëndësishme familjare si vdekje, lindje apo martesë kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentin zyrtar që provon vdekjen, lindjen apo martesën.

b) Pas marrjes së kërkesës së argumentuar nga i burgosuri drejtori IEVP, urdhëron brenda ditës së marrjes së kërkesës, përgjegjësin e sektorit ligjor, përgjegjësin e sektorit të sigurisë dhe përgjegjësin e sektorit të kujdesit social, për shqyrtimin dhe përgatitjen e dokumentacionit që do të shërbejë si bazë e miratimit apo refuzimit të lejes së veçantë.

c) Përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i sektorit të kujdesit social, përgatisin brenda një afati 1-ditor nga dita e marrjes së urdhërit, raportin e përbashkët i cili shpjegon dhe dokumenton se i burgosuri ka lidhje familjare të ngushtë me personin e sëmurë rëndë, të vdekur, të lindur ose të martuar, ekzistencën e dokumentacionit që vërteton rastin ligjor, kohëzgjatjen e vuajtjes së dënimit, lejet e kryera mëparë, respektimin e kësaj rregulloreje dhe rregullores së brendshme të IEVP nga i burgosuri, rrezikshmërinë e tij, besueshmërinë që paraqet i burgosuri lidhur me qëndrimin e tij jashtë institucionit, si dhe propozimin e argumentuar të miratimit apo refuzimit të lejes së veçantë dhe të ditëve që i burgosuri duhet të marrë si leje e veçantë.

ç) Raporti, propozimi dhe dokumentacioni i paraqiten brenda 1 dite drejtorit të IEVP, i cili e shqyrton dhe jep miratimin apo refuzimin e motivuar.

d) Leja e veçantë mund të miratohet nga drejtori i IEVP, vetëm pasi të ketë marrë të paktën dy mendime në favor të miratimit të saj nga përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të sigurisë dhe përgjegjësi i kujdesit social.

2. Leja e veçantë me kohëzgjatje deri në 12 (dymbëdhjetë) orë, për të burgosurit, bëhet me shoqërim. Drejtori që jep lejen, duhet të përcaktojë mënyrën, kushtet, mjetet e shoqërimit të burgosurit, me forca të policisë së burgjeve dhe numrin e tyre.

3. Leja e veçantë mund të jepet deri në 7 ditë dhe mund të zgjatet me miratimin e drejtorit të IEVP, vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, pasi i burgosuri të ketë plotësuar kërkesat e shkronjës

“a” të pikës 1 të këtij neni, lidhur me rastin e sëmundjeve të rënda. Kohëzgjatja e lejes së veçantë nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

KREU VIII NJOFTIM PËR VDEKJET, SËMUNDJET DHE TRANSFERIMET

Neni 71

Njoftimet për rastet e sëmundjeve, vdekjeve e transferimeve

1. Në rastet e sëmundjeve të rënda, dëmtimeve serioze të të burgosurit apo dërgimit të tij në një institucion tjetër për kurim, drejtori i IEVP, informon menjëherë familjarët ose të afërmit dhe në çdo rast, çdo person tjetër i caktuar më parë nga i burgosuri.

2. I burgosuri duhet të njoftohet menjëherë për vdekjen dhe sëmundjen e familjarëve dhe të të afërmeve të tij.

Neni 72

Veprimet në rast vdekjeje

1. Në rast vdekjeje të të burgosurit, mjeku në përputhje me rregullat në fuqi, paraqet menjëherë raportin e hartuar prej tij në drejtorinë e IEVP.

2. Drejtoria e IEVP, njofton menjëherë prokurorin, i cili vendos për bërjen ose jo të autopsisë ose që trupi t’u jepet familjarëve për organizimin e shërbimeve funerale. Gjithashtu, njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, familjarët dhe autoritetet e gjendjes civile.

3. Sendet personale të të burgosurit inventarizohen. Kopja e inventarit i dërgohet organeve të pushtetit vendor të vendbanimit të tij. Këto sende iu dorëzohen kundrejt nënshkrimit të familjarëve të të burgosurit të vdekur, pasi të jenë verifikuar identiteti dhe lidhja familjare. Depozita në të holla, i dorëzohet kundrejt nënshkrimit vetëm personave që provojnë se janë trashëgimtarë të të burgosurit të vdekur.

4. Në qoftë se brenda gjashtë muajve nga vdekja e të burgosurit, sendet e tij nuk janë tërhequr nga familja ose të afërmit e tij, ato dërgohen në organet e qeverisjes vendore të vendbanimit të tij.

5. Në rast se kufoma e të burgosurit, nuk merret nga familja ose të afërmit e tij, personeli i IEVP, kujdeset për varrosjen e tij në varrezat publike, duke përballuar shpenzimet e nevojshme. Regjistrimi i këtij fakti bëhet në regjistrin themeltar, i cili plotësohet nga kartelisti.

Neni 73

Veprimet në rast vdekjeje të të burgosurve të huaj

1. Në rastin e vdekjes të të burgosurve të huaj, refugjatë apo persona pa shtetësi, njoftimi i vdekjes bëhet nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, përfaqësuesit diplomatik, ose Konsullor në Republikën e Shqipërisë të shtetit të cilit ai i përket, përfaqësuesit të shtetit që merr në mbrojtje interesat e tyre ose nëpërmjet autoriteteve kombëtare apo ndërkombëtare, që kanë për qëllim të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave.

2. Në rastin e të burgosurve që nuk u dihet vendbanimi, familjarët ose personat e tjerë të caktuar më parë nga i burgosuri, njoftimi i tyre bëhet në të paktën dy media kombëtare për një periudhë 10-ditore.

KREU IX TRANSFERIMI I TE BURGOSURVE

Neni 74

Kërkesa për transferim

1. Kërkesa për transferimin e të burgosurit në një IEVP tjetër, mund të paraqitet nga i

burgosuri ose familjarët e tij, për arsye shëndetësore, familjare, shkaqe të formimit profesional, kur i rrezikohet jeta ose shëndeti i tij, si dhe mundësia e vuajtjes së dënimit pranë vendbanimit të familjarëve të tij.

2. Kërkesa për transferimin e të burgosurit në një institucion tjetër mund të paraqitet nga prokurori i çështjes për nevoja të hetimit dhe gjykimit.

3. Kërkesa për transferimin e të burgosurit në një IEVP tjetër, mund të paraqitet nga drejtori i IEVP, në rastet e mbipopullimit në IEVP, për arsye sigurie kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të burgosurit nga të tjerë, si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 75

Shqyrtimi i kërkesës për transferim

1. Me paraqitjen e kërkesës për transferimin e të burgosurit drejtori i IEVP, e regjistron menjëherë kërkesën në një regjistr të veçantë si dhe urdhëron përkatësisht sektorin ligjor, sektorin e ruajtjes dhe sigurisë, sektorin e kujdesit shëndetësor apo sektorin e kujdesit social që, brenda një afati 5-ditor nga dita e regjistrimit të kërkesës, të përgatisë një raport të hollësishëm sipas argumentimit të paraqitur në kërkesë.

a) Kur kërkesa për transferim bazohet në arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të burgosurit nga të tjerët ose kur ka mbipopullim në IEVP, sektori i sigurisë përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhëna dhe prova për vërtetimin e shkakut për transferimin e të burgosurit;

b) Kur kërkesa për transferim bazohet në nevoja të hetimit dhe gjykimit, sektori ligjor përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm, ku jepen të dhëna mbi gjëndjen gjyqësore të të burgosurit, dinamikën e vuajtjes së dënimit, si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga organet e drejtësisë ku është kërkuar transferimi i të burgosurit;

c) Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe shëndetësore, sektori i kujdesit shëndetësor përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm ku jepen të dhënat e nevojshme mbi gjëndjen shëndetësore të të burgosurit, raportet dhe analizat mjekësore që vërtetojnë gjëndjen të të burgosurit dhe nevojën shëndetësore për transferimin e të burgosurit;

ç) Kur kërkesa për transferim bazohet në shkaqe familjare, të formimit profesional si dhe në afërsinë me vendbanimin e familjarëve të tij, sektori i kujdesit social përgatit një raport të arsyetuar dhe të hollësishëm, ku jepen të dhëna gjëndjen familjare, vendbanimin e familjarëve të të burgosurit, gjëndjen sociale, arsimore dhe profesionale të të burgosurit, si dhe për referencat zyrtare të ardhura nga institucionet e tjera shtetërore të cilat vërtetojnë shkakun familjar, të vendbanimit të familjarëve, si dhe formimin profesional.

2. IEVP, ku ndodhet i burgosuri, mund të kërkojë nga institucionet e tjera shtetërore, të dhëna provuese apo shtesë, lidhur me shkakun e transferimit të të burgosurit, të cilat i bashkëlidhen raportit.

3. Raporti i përgatitur nga sektori përkatës, i paraqitet drejtorit të IEVP, i cili vendos nëse kërkesa për transferim është apo jo e bazuar në ligj dhe e arsyetuar në raport. Nëse drejtori i IEVP, çmon se kërkesa për transferim është e bazuar, përcjell brenda një afati 2-ditor nga dita e paraqitjes së raportit, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, kërkesën, raportin, si dhe propozimin e tij të argumentuar lidhur me transferimin e të burgosurit dhe IEVP ku mund të sistemohet i burgosuri.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, që nga momenti i regjistrimit të kërkesës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve urdhëron strukturat përkatëse lidhur me:

a) mundësinë e transferimit të të burgosurit të trajtuar në kërkesat e rregjistruara në institucionet e tjera duke marrë në konsideratë propozimin e drejtorit të IEVP që ka përcjellë kërkesën;

b) shkallën e sigurisë së të burgosurit;

c) si dhe koordinimin e dy IEVP, lidhur me transferimin e të burgosurit dhe kryerjen e procedurave përkatëse.

Pas verifikimit sipas pikës 4 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhërin lidhur miratimin apo refuzimin e transferimit e të burgosurit. Në rast se kërkuuesi nuk është dakord me përgjigjen e dhënë, ai ka të drejtë t'a ankimojë atë tek Ministri i Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e refuzimit të kërkesës.

5. Në rast se kërkesa për transferim rezulton e pambështetur në ligj, drejtori i IEVP përmes

Sektorit Ligjor, përgatit përgjigjen e arsyetuar drejtuar kërkuesit. Në rast se kërkuesi nuk është dakord me përgjigjen e dhënë, ai ka të drejtë ta ankimojë atë tek Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes dijeni të përgjigjes së drejtorit të IEVP. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve vendos lidhur me transferimin e të burgosurit brenda 15 ditëve nga paraqitja e ankesës.

Neni 76

Realizimi i transferimit të të burgosurve

1. Transferimi i të burgosurve bëhet në një mënyrë sa më pak të njohur nga publiku dhe duke siguruar mbrojtjen nga çdo formë fyerje, kurioziteti ose publikimi. Ndalohet transferimi i të burgosurve me mjete transporti që nuk kanë ndriçim dhe ventilim të përshtatshëm, ose që në ndonjë mënyrë mund t'i verë ata para vuajtjeve fizike dhe poshtërimit.

3. I burgosuri, përpara se të transferohet i nënshtrohet kontrollit personal dhe vizitohet nga mjeku, i cili verifikon gjendjen psiko-fizike të tij dhe konkludon nëse është në gjendje të përballojë udhëtimin. Në qoftë se i burgosuri nuk mund të përballojë udhëtimin, drejtorja e IEVP njofton autoritetin që ka urdhëruar transferimin e të burgosurit.

4. Përpara transferimit të të burgosurit, i dorëzohen kundrejt nënshkrimit sendet personale që lejohet të marrë me vete në përputhje me kriteret dhe kufijtë e parashikuar në rregulloren e brendshme të IEVP.

5. Përgjegjësi i grupit të shoqërimit të të burgosurit që transferohet, merr në dorëzim nga institucioni:

- a) sende ushqimore në sasi dhe cilësi të përshtatshme me nevojat e të burgosurit gjatë udhëtimit, ose të holla për blerjen e këtyre sendeve për nevoja njëditore;
- b) dosjen e plotë personale të të burgosurit.

Përgjegjësi i grupit të shoqërimit mban një procesverbal për sendet, vlerat dhe dokumentet e mësipërme të marra në dorëzim. Sendet, vlerat dhe dokumentet e mësipërme, dorëzohen në IEVP ku transferohet i burgosuri me procesverbal.

Transportimi i të burgosurve realizohet me shpenzimet dhe nën drejtimin e administratës së IEVP.

PJESA E KATËRT REHABILITIMI I TË BURGOSURVE

KREU I KUJDESI SOCIAL NË IEVP

Neni 77

Qëllimet e kujdesit social

1. Trajtimi human i të burgosurve bëhet në përshtatje me kapacitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ata kanë.

2. Për realizimin e rehabilitimit social të të burgosurve, IEVP duhet të vërë në dispozicion të gjitha burimet e përshtatshme, duke realizuar përkrahjen morale, kualifikimin profesional, arsimimin, edukimin fizik, zhvillimin e aftësive shoqërore, këshillimin, pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta dhe nxitjen e kontakteve me jashtë, në mënyrë që të zgjerohet perspektiva e riintegritit shoqëror pas lirimit.

Neni 78

Vëzhgimi dhe programet e trajtimit

1. Personeli i edukimit realizon vëzhgimin e personalitetit të të burgosurit, me qëllim qartësimin e nevojave lidhur me mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetit të të burgosurit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij.

Bazuar në këto, si dhe në të dhënat personale, familjare e shoqërore, masën e dënimit, ndërtohet programi individual i trajtimit të të burgosurit, i cili realizohet nga një grup ekspertësh të fushave social-psikologjike e pedagogjike. Programi individual përfshin terapi, këshillim, shërbim bibliotekar etj.

2. Punonjësi i edukimit në IEVP i evidenton të dhënat e grumbulluara nga vëzhgimi dhe trajtimi individual, si dhe nga sjellja gjatë gjithë periudhës së burgimit në dosjen psiko-sociale. Këto shërbejnë për përmirësimin e trajtimit të mëtejshëm, si dhe për hartimin e vlerësimit të sjelljes.

3. Programi individual i trajtimit të të burgosurit diskutohet me të burgosurin. Ky program mund të ndryshohet në varësi të ecurisë së të burgosurit.

Neni 79

Pjesëmarrja në aktivitete dhe veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive

Procesi i edukimit përfshin edhe programe të trajtimit në grup të të burgosurve, duke iu dhënë mundësi atyre të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të institucionit të cilat i ndihmojnë ata të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetëbesimit, si dhe të nxisin interesin, si arsimimin, formimi profesional, veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive, puna etj.

Neni 80

Shërbimi bibliotekar

1. Në çdo IEVP duhet të ketë një bibliotekë për përdorim nga të gjithë të burgosurit.

2. Shërbimi i bibliotekës organizohet dhe mbikëqyret nga personeli përgjegjës, i cili kujdeset për mirëmbajtjen dhe pasurimin e saj, shpërndarjen e literaturës dhe përhapjen e dijes dhe të kulturës.

3. Në përzgjedhjen e literaturës duhet të mbahet parasysh sigurimi sa më i mirë i pluralizmit shkencor, kulturor dhe artistik.

4. Favorizohet leximi pa kufizim i publikimeve dhe përdorimi i sistemeve të tjera informative të bibliotekës së institucionit.

5. Çdo bibliotekë në institucion duhet të ketë literaturë për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, legjisllacionin bazë penal, procedural penal dhe në fushën e trajtimit të të burgosurve.

KREU II ARSIMIMI

Neni 81

Arsimimi

1. Të burgosurit që nuk e ka përfunduar arsimin nëntëvjeçar, i krijohen kushte për përfundimin e tij, me program të veçantë të miratuar nga Ministria e Arsimit.

2. Për të miturit e burgosur merren masa që të mos ndërpresin vazhdimin e arsimit të detyruar.

3. Mësimdhënia realizohet nga mësues. Në përfundim, i burgosuri pajiset me dokumentin që vërteton përfundimin e arsimimit dhe rezultatet e tij.

4. I burgosuri nxitet të marrë pjesë për arsimimin në nivele më të larta brenda dhe jashtë IEVP. Për të burgosurit që studiojnë në nivelin 9-vjeçar dhe të mesëm, IEVP merr përsipër mbulimin e shpenzimeve për arsimim.

Neni 82

Kurset profesionale

1. Në IEVP organizohen kurse për përgatitjen profesionale të të burgosurve.

Mësimdhënia në këto kurse realizohet në IEVP ose jashtë tij nga profesionistë, përzgjedhja e të cilëve dhe dhënia e autorizimit përkatës bëhet nga drejtori i IEVP.

2. I burgosuri nxitet për nevojën dhe frekuentimin e kurseve të formimit profesional.

KREU III PUNA E TË BURGOSURVE

Neni 83 **Punësimi**

1. Të burgosurit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me aftësitë fizike, shëndetësore dhe psikologjike.
2. Puna nuk ka karakter dënimi.
3. Aktet ligjore dhe nënligjore që shërbejnë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenies sociale dhe kohëzgjatjen e punës, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të ushtrimit të drejtës së grevës dhe të pjesëmarrjes në sindikata, zbatohen njëjloj edhe për të burgosurit.
4. Personat e burgosur mund të punësohen duke:
 - a) Lidhur kontratë pune me IEVP;
 - b) Lidhur kontratë pune me persona të tretë juridikë, vendas apo të huaj për punë e cila mund të kryhet brenda ambienteve të IEVP, apo jashtë tij nëpërmjet/me aprovimin e drejtorit të IEVP;
 - c) u vetëpunësuar.
5. Të burgosurit që kanë probleme psikike, mund të vihen në punë kur kjo i shërben qëllimeve terapeutike. Vërtetimi i gjendjes së treguar në këtë pikë do të bëhet kundrejt raportit mjekësor përkatës, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi.
6. Drejtori i IEVP, ku do të zhvillohet aktiviteti i punës, sigurohet që i burgosuri të punojë duke pasur parasysh formimin profesional, aftësitë fizike dhe mendore të tij. Me urdhër të Drejtorit të IEVP, të burgosurit i kërkohet të marrë pjesë në parandalimin e katastrofave natyrore, epidemike, aksidenteve ose eliminimin e pasojave të tyre.

Neni 84 **Shpërblimi për punën**

1. Paga për punën e të burgosurit nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Paga përbëhet nga:
 - a) të ardhurat që i jepen periodikisht të burgosurit të punësuar nga administrata e IEVP, për të mbuluar shpenzimet e zakonshme gjatë qëndrimit në burg;
 - b) shuma që IEVP, ruan në llogarinë personale të burgosurit të punësuar, e cila i jepet atij kur përfundon ekzekutimi i vendimit me burgim, shumë e cila përbëhet nga të paktën 10 % e vlerës së pagës për punën.
 - c) shuma që i përgjigjet detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatimeve, si dhe detyrimeve dhe shpenzimeve që ka i burgosuri gjatë kohës së qëndrimit në burg, të cilat përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.
3. I burgosuri, në përputhje me paragrafin “d” të nenin 73 të Kodit Civil, mund të autorizojë që të afërmit të disponojnë mbi të ardhurat e depozituara në llogarinë e tij, duke lënë detyrimisht në llogari një shumë jo më të vogël se gjysma e pagës minimale mujore në muaj.
4. Paga për punën, si dhe shpërblimet e mundshme përcaktohen në kontratën e punës.
5. Drejtori i IEVP përcakton në kontratat e punës, kur është punëdhënës vetë, sanksione për të burgosurin punëmarrës, në rastet e keqdashjes, mungesës së vullnetit apo cilësisë së dobët të kryerjes së punës dhe detyrave të tjera të ngarkuara.
6. Paga, si dhe shpërblimet e mundshme për punën derdhen në llogarinë personale të punëmarrësit, përveç kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi, nga kontrata e punës ose kur punëmarrësi ka rënë vetë dakord për një mënyrë tjetër pagimi.
7. Punëmarrësit kanë të drejtë të mbrohen nga përfaqësuesi i tyre ligjor për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia kontraktuale e punës.

Komisioni i përhershëm i vlerësimit të punës në burgje

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ngrihet Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Aktivitetit të Punës në Burgje, në vijim “Komisioni”.

2. Komisioni ka përbërjen e mëposhtme:

- a) Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në cilësinë e kryetarit të Komisionit;
- b) Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, anëtar;
- c) Një përfaqësues nga Ministria e Financës, anëtar;
- ç) Një përfaqësues nga Ministria që mbulon fushën e punës dhe çështjeve sociale, anëtar;
- d) Tre përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, anëtar.

3. Në mbledhjet e tij, Komisioni është i detyruar të thërrasë si të ftuar edhe drejtorin e IEVP ku ndodhen të burgosurit, të propozuar për lidhjen e kontratave të punës.

4. Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Aktivitetit të Punës në Burgje është organi përgjegjës për zbatimin e politikave dhe ndjekjen e aktivitetit të punësimit të burgosurve.

5. Komisioni ka këto kompetenca:

- a) Zbatimin e politikave të punësimit dhe veprimtarive kërkimore për gjetjen e zgjidhjeve dhe zbatimin e metodave bashkëkohore në fushën e punësimit të burgosurve;
- b) Organizimin, drejtimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së punës me institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera me qëllim punësimin dhe shpërblimin e drejtë të burgosurve;
- c) Propozimin e akteve ligjore dhe nënligjore;
- ç) Shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga personat juridikë publikë ose privatë për projektet e punësimit, të të dënuarve me burgim, sipas kriterëve të përgjithshme të kësaj rregulloreje apo të kriterëve të veçanta të miratuara nga Ministri i Drejtësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe miraton ose refuzon projektin, duke deklaruar shkaqet për çdo rast;

d) Marrjen e masave efektive për të siguruar që punëmarrësit përpara punësimit të njihen me kushtet, masën dhe mënyrën e shpërblimit, si dhe çdo ndryshim të natyrës së punës;

dh) Organizimin e studimeve periodike për kërkesat dhe ofertat për punë, kualifikimin profesional të të dënuarve me burgim, mundësitë dhe kushtet për zhvillimin e aktivitetit të punës në institucione;

e) Ushtrimin e kontrolleve në institucionet e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për zhvillimin e aktivitetit të punës dhe mbajtjen e dokumentacionit në formën dhe mënyrën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

ë) Përgatitjen e informacioneve dhe raportit periodik vjetor për Ministrin e Drejtësisë mbi veprimtarinë ekonomike dhe atë të punësimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

f) Mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve të burgosur që lindin nga marrëdhënia e punës nëpërmjet konstatimit kryesisht të shkeljeve apo mbi bazën e ankesës;

g) T’i kërkojë drejtorit të IEVP kur është punëdhënësi, marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave të njohura për punëmarrësit nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe t’i kërkojë atij sigurimin e respektimit të të drejtave të mësipërme nga punëdhënësit e tjerë.

6. Komisioni e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

7. Mbledhjet e Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Aktivitetit të Punës në Burgje zhvillohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Procedura e vlerësimit dhe miratimit të kërkesës për të zhvilluar aktivitetin e punës

1. Kërkesa që paraqitet për zhvillimin e aktivitetit të punës duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin standard të aplikimit, i plotësuar, i cili miratohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozim të Komisionit;

b) Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik të kërkuarit, në të cilin duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkohet të punësojë të burgosurin;

c) çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor;
ç) Vërtetim nga gjykata, prokuroria, shërbimi i përmbartimit dhe organet tatimore, ku tregohet se personi i interesuar nuk është në proces gjyqësor penal, hetimor apo ka detyrime të pashlyera;

d) Informacion të detajuar mbi:

- llojin e aktivitetit që kryen;
- numrin e fuqisë punëtore të punësuar;
- nivelin e pagës që ai paguan për punëmarrësit;

dh) Numrin e llogarisë bankare;

e) Relacion përshkrues të projektit të punës dhe të dhëna mbi:

- numrin e punonjësve që kërkon të punësojë;
- profesionin për të cilin do të punësohen;
- përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtorë;
- kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës;
- llojin e kontratës që kërkon të zbatojë;
- nivelin e pagës që propozon për punëmarrësit e tij.

ë) Të dhënat financiare të vitit të mëparshëm nëpërmjet bilancit të konfirmuar nga organet tatimore, i cili duhet të rezultojë pozitiv në mënyrë që kërkesa e personit juridik të merret në konsideratë.

Në çdo rast që e gjykon të nevojshme, Komisioni mund të kërkojë të dhëna të tjera nga punëdhënësi që ka paraqitur projektin.

2. Komisioni merr vendim brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës. Në rast mospranimi të kërkesës apo projektit të punës, Komisioni duhet të shprehet në mënyrë të arsyetuar për mospranimin e saj.

3. Ndaj vendimeve të Komisionit për refuzimin e kërkesës apo projektit të punës, mund të bëhet ankim administrativ te Ministri i Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe në gjykatë sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 87

Procedura e punësimit të të burgosurit

1. Çdo i burgosur që kërkon të punësohet, i paraqet kërkesë drejtorit të IEVP, i cili merr në konsideratë natyrën e punës për të cilën i burgosuri ka paraqitur kërkesë, gjendjen ekonomike të familjes së tij, kohën e qëndrimit në IEVP, kohën e kaluar në gjendje joaktive në punë gjatë periudhës së ekzekutimit të vendimit me burgim, mënyrën e sjelljes së të burgosurit, aftësitë profesionale të tij, detyrat e tjera të ngjashme të kryera në të kaluarën, personalitetin e tij, mundësitë objektive dhe hapësirat e lira në ambientet e IEVP ku zhvillohet aktiviteti i punës, si dhe çdo element tjetër për kryerjen e punës dhe brenda 10 ditëve aprovon kërkesën apo, sipas rastit, lidh kontratën e punës. Në rast refuzimi, i kthen përgjigje me shkresë kërkuarës, duke paraqitur shkaqet e refuzimit.

2. Për çdo kërkesë për punësim të të burgosurve, drejtori i IEVP, vlerëson kriteret e paragrafit të mësipërm lidhur me rrezikshmërinë dhe sigurinë, dhe vendos mbi punësimin brenda ose jashtë IEVP.

3. Punët me karakter artistik, artizanal ose intelektual mund të zhvillohen në ambientet e IEVP, me kusht që kjo të mos kryhet nëpërmjet përdorimit të pajisjeve të rrezikshme për rendin dhe sigurinë në burgje dhe të mos përbëjnë shqetësim për të burgosurit e tjerë.

4. Me miratimin e kërkesës individuale për zhvillimin e aktivitetit të punës, drejtori i IEVP urdhëron krijimin e kushteve të nevojshme dhe plotësimin e procedurave ligjore për punësimin e të burgosurit. Nëse punëdhënësi është person i tretë, kontrata e punës lidhet midis tij dhe burgosurit, ose drejtorit IEVP ku ndodhen të burgosurit, kur aplikohet kontrata e grupit.

Neni 88

Zbatimi i projekteve të punësimit

1. IEVP, ku do të zhvillohet aktiviteti i punës, duke respektuar legjislacionin në fuqi, iu

siguron personave juridikë publikë ose privatë, vendas apo të huaj të interesuar, gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me projektet e punësimit. Në IEVP, me fonde të buxhetit të Shtetit, mund të zbatohen projekte për nxitjen e punësimit.

2. Në projektet e punësimit të të burgosurve, punëdhënësi duhet të parashikojë që t'i japë punëmarrësit mjetet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e punës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me marrëveshje ose kur këto mjete apo materiale mund të cenojnë sigurinë në burgje.

3. Në projektet e paraqitura, punëdhënësi duhet të parashikojë edhe sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës, mbrojtjen në punë, sigurimin teknik, kushtet higjieno-shëndetësore, mundësinë e përbalimit të shpenzimeve për ushqim dhe trajtim mjekësor të punëmarrësve, transportin e punonjësve në qendrën e punës në rastin e punës jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit të punës.

4. Në vlerësimin e projekteve të punës së kryer brenda IEVP, për shfrytëzimin e ambienteve të punës mund të kërkohej shtesë e arsyetuar shpenzimesh ndaj punëdhënësve.

5. Pas miratimit të projektit të punësimit, Komisioni autorizon drejtorin e IEVP ku do të zhvillohet aktiviteti i punës, për marrjen e masave për lidhjen e kontratave të punës, në përputhje me rregullat që parashikon ligjin nr.8328, datë 16. 4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ligji nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe aktet e tjera nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

6. Kontratat e punës të burgosurit nuk duhet të përmbajnë kushte më pak të favorshme se ato të parashikuara në kontratën e punës për punëmarrësit në gjendje të lire, me përjashtim të kufizimeve që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore për këtë kategori të punësuarish.

7. Në vlerësimin e projekteve, Komisioni, përveç kritereve të përcaktuara në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” të ndryshuar, kësaj rregulloreje, mund të marrë në konsideratë edhe kërkesa të veçanta të miratuara nga Ministri i Drejtësisë në bazë dhe për zbatim të kësaj rregulloreje apo ligjeve në fuqi.

8. Përveç rasteve të parashikuara, në ligj për masat disiplinore, punëdhënësi mund të përjashtojë të burgosurin nga puna duke respektuar procedurën ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës, për shkaqe që konsiderohen të arsyeshme në bazë të legjislacionit të punës në fuqi.

9. Personat juridikë, publikë ose privatë, vendas apo të huaj mbajnë dokumentacionin e nevojshëm për punën e të burgosurve. Formatet e dokumenteve hartohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës dhe miratohen nga Ministri i Drejtësisë.

10. Administrata e çdo IEVP harton dhe i dërgon çdo muaj Komisionit informacion në lidhje me zbatimin e projekteve të punës, si dhe çdo të dhënë tjetër për punësimin e të burgosurve.

11. Në fund të çdo viti, Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Aktivitetit të Punës në Burgje përgatit një informacion të hollësishëm lidhur me punësimin e të burgosurve, kërkesat dhe nevojat për punë dhe shërbime, planifikimin e investimeve, ngritjen e reparteve të punës, si dhe çdo problem tjetër që lidhet me këtë aktivitet dhe e paraqet tek Ministri i Drejtësisë.

KREU IV LIRIMI I TË BURGOSURVE

Neni 89

Përgatitja e të burgosurve për lirim

1. Administrata e IEVP, nisur nga vetë parimet themelore dhe qëllimet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të vuajtjes së dënimit, synon dhe duhet të marrë masa për të përgatitur të burgosurin për lirim që në fillim të vuajtjes së dënimit.

2. Në periudhën e vuajtjes së dënimit dhe në veçanti, sipas masës së dënimit dhe mundësive, jo me vonë se 6 muaj nga dita e lirit të të burgosurit, edukatorët përkatës, marrin masa dhe zhvillojnë një program të veçantë trajtimi, duke komunikuar dhe bashkëbiseduar me të dënuarin për problemet që ai duhet të përballojë pas lirit, si dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre duke bashkëpunuar edhe me autoritetet vendore të vendbanimit të të burgosurit.

3. Për realizimin e këtij procesi, personeli i IEVP duhet të bashkëpunojë edhe me subjekte,

shoqata të ndryshme të interesuara, Shërbimin e Provës, e në veçanti ata që kanë objekt të veprimtarisë se tyre çështjet sociale, familjare dhe punësimin.

Neni 90

Lirimi i të burgosurit

Drejtori i IEVP nxjerr urdhrin për lirim të të burgosurit, kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose në bazë të ligjit. Për të burgosur të cilët nuk kanë mjete financiare dhe veshmbathje, drejtori i IEVP mund të nxjerrë urdhrin nëpërmjet të cilit i jepet ndihmë financiare dhe veshmbathje të burgosurit, në varësi të kushteve ekonomike familjare, gjendjes financiare në llogarinë personale të tij, largësisë së vendbanimit nga IEVP.

PJESA E PESTË PERSONELI I IEVP.

Neni 91

Personeli

Personeli i IEVP realizon administrimin e veprimtarisë në IEVP, në përputhje me standardet njerëzore, me efikasitet dhe efikasitet ndaj detyrave të ngarkuara, duke informuar vazhdimisht opinionin publik për rolin e sistemit të burgjeve dhe punën e personelit.

Neni 92

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve

1. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve është funksionari më i lartë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe është përgjegjës për sistemin penitenciar. Ai raporton tek Ministri i Drejtësisë për të gjitha problemet që lidhen me veprimtarinë e sistemit të burgjeve.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka këto kompetenca:

a) I propozon Ministrit të Drejtësisë emërimin, lirim dhe shkarkimin e drejtorëve të IEVP.

b) I propozon Ministrit të Drejtësisë emërimin, lirim dhe shkarkimin e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm.

c) Emëron, liron dhe shkarkon të gjithë punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve përveç personelit marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me akte ligjore e nënligjore të veçanta;

ç) Urdhëron lëvizjen dhe transferimin e të burgosurve në IEVP;

d) Përgjigjet për gjendjen financiare dhe administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe atyre të varësisë;

dh) Përgjigjet për kushtet e jetesës dhe trajtimit të burgosurve në IEVP dhe respektimit të të drejtave të tyre sipas legjislacionit në fuqi.

e) Mbikëqyr administrimin e godinave, mjediseve dhe pajisjeve të sistemit penitenciar.

Neni 93

Drejtimi i IEVP

1. Veprimtaria e IEVP drejtohet dhe kontrollohet nga drejtori i tij, i cili është përfaqësues ligjor i institucionit me të tretët.

2. Drejtori i IEVP është përgjegjës për zbatimin e ligjit në veprimtarinë e institucionit që drejton dhe për trajtimin njerëzor, dinjitoz, të barabartë e të paanshëm të të burgosurve. Ai përgjigjet për administrimin e mirëmbajtjen e godinave, mjediseve dhe pajisjeve të institucionit që drejton.

3. Drejtori i IEVP në rast mungese, zëvendësohet nga zëvendës drejtori. Në mungesë dhe me porosi të tyre, mund të autorizohet një punonjës i IEVP për kryerjen e veprimeve apo përmbushjen e porosive të veçanta të caktuara.

4. Drejtori i IEVP emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë kryesisht ose me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

5. Zëvendësdrejtori i IEVP, emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga drejtori i IEVP me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

6. Punonjësit e tjerë të IEVP emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve me propozim të Drejtorit të IEVP përveç personelit marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me akte ligjore e nënligjore të veçanta.

Mënyra e mbledhjes së dosjeve, shqyrtimit të tyre, intervistimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe ndjekjes së procesit të trajnimit të stafit të IEVP, përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 94

Rregulla të përgjithshme për procedurën e emërimeve, lirimeve dhe shkarkimeve

1. Propozimet për emërim, lirim dhe shkarkim duhet të shoqërohen në çdo rast me dokumentacionin përkatës.

2. Në pozicione drejtuese në sistemin e burgjeve mund të emërohet personi që plotëson këto kritere:

a) të ketë arsimin e lartë;

b) të ketë përvojë pune të paktën 5 vjet.

3. Ka të drejtë të konkurojë në sistemin e burgjeve për t'u pranuar si punonjës çdo person që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) është shtetas shqiptar;

b) ka zotësi të plotë për të vepruar;

c) është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;

ç) ka mbaruar arsimin përkatës;

d) nuk është dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Aktet për emërimin, lirin ose shkarkimin e punonjësve duhet të jenë me shkrim dhe të motivuara.

5. Drejtuesit përkatës lidhin kontratat e punës për të gjithë punonjësit e sistemit penitenciar, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës.

6. Të gjithë punonjësit e sistemit penitenciar i nënshtrohen trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm.

PJESA E GJASHTË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 95

Zbatimi i rregullores

1. Brenda 3 muajve nga miratimi i kësaj rregulloreje, Komisioni përgatit dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat dhe nevojat për zhvillimin e aktivitetit të punës së të burgosurve sipas kriterëve të kësaj rregulloreje. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të mbajë dokumentacionin e nevojshëm për punën e të burgosurve sipas formateve të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.

2. Rregulloret e brendshme të IEVP mbeten në fuqi deri në miratimin e rregulloreve të reja.

3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e kësaj rregulloreje.